



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE



DOGANA E KOSOVËS
CARINA KOSOVA- KOSOVO CUSTOMS

04.3.2/861
L.I. - KI/0151

Dogana e Kosovës - Sektori i Auditimit të Jashtëm, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, për subjektin në procedurë “**Ministria e Punëve të Brendshme**” me seli në Prishtinë, me nr. Fiskal 600132823 i autorizuar në vështrim të nenit 7 pika 1; 262 të Kodit Doganor dhe Akcizave (Nr.03/L-109) si dhe nenit 83 të Ligjit mbi procedurën administrative (LPA) nxjerrë këtë:

A K T V E N D I M

I. NDRYSHOHEN të dhënat në Deklaratat Unike Doganore me regjim IM4 13998/23.09.2011; IM4%16403/28.10.2011; IM4%16772/02.11.2011; IM4%17883/22.11.2011 të proceduar ne Z.D. Pejë;

II. Ndryshimin e të dhënave do ta kryej Sektori i Auditimit të Jashtëm.

III. OBLIGOHET importuesi “**Ministria e Punëve të Brendshme**” me seli në Prishtinë, me nr. Fiskal 600132823 që të paguaj obligimet doganore si në vijim:

Baza Doganore	1,282,800.00 €
Taksë doganore (10%)	128,280.00 €
TVSH (16%)	225,772.20 €
Gjithsej:	354,052.20 €

IV. Ankesa e paraqitur kundër këtij vendimi nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

ARSYETIM

Sektori i Auditimit të Jashtëm duke vepruar sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 82 pika 1 dhe 3 të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës, bazuar në delegimin e kompetencës, sipas kërkesës nga Zyra Doganore Pejë dhe Zyra Doganore Intereuropa për auditimin e lëndëve të importuesit “*Ministria e Punëve të Brendshme*” me seli në Prishtinë, malli “*Pasaporta Elektronike (biometrike)*”, ka kryer procedurat e nevojshme për të audituar lëndet e cekura më lartë.

Me datë 07.12.2012 ishim në vizitë në Departamentin për prodhimin e dokumenteve në kuadër të MPB përgjegjesit na informuan se pasaportat janë të importuara si dokumente të lidhura dhe me kartelën e integruar të zbrazët; informata personale, fotografia dhe plotësimi i karteles (çipit) ishin veprimet e vetme që ndërmerreshin nga ky Departament para se Pasaportat të ishin të gatshme për shpërndarje.

Sektori i tarifës (prezent gjatë vizitës në MPB), mblodhën informacione dhe prova konkrete të cilat ju ndihmuan në përcaktimin e drejtë të kodit tarifor 4911 9900 00 si dhe përshkrimit të mallit – Dokumente identifikuese – Pasaporta biometrike.

Sektori i Auditimit, duke u bazuar në mendimin për klasifikimin tarifor me nr.49-T/2012 datë 04.12.2012 e Sektorit Tarifa, konstaton se me rastin e deklarimit dhe zhdoganimit të mallit nuk është vepruar drejtë. Malli lëndor duhet t'i nënshtrohet pagesës së taksave importuese me shkallën prej 27.6%.

Gjatë shqyrtimit të lëndës janë marr masat e nevojshme për rregullimin e gjendjes duke bërë ndryshimin e të dhënave në Deklaratat Unike Doganore, si më poshtë:

Ndryshohen të dhënat në DUD-at me regjim IM4 13998/23.09.2011; IM4%16403/28.10.2011; IM4%16772/02.11.2011; IM4%17883/22.11.2011 të proceduar ne Z.D. Pejë;

- rubrika 31 emërtimi i mallit- nga “*letër për printimin e pasaportave biometrike*” siç ishte, në “*dokumente identifikuese- Pasaporta elektronike – biometrike*” siç duhet të jetë;
- rubrika 33 numri tarifor i mallit – nga 4901 9900 00 siç ishte, në 4911 9900 00 siç duhet të jetë.

Sektori i Auditimit të Jashtëm duke u bazuar në faktet e lartcekura, përmirëson të dhënat ne DUD-at e lartë cekur për detyrimet doganore dhe TVSH-së në vlerë prej 354,052.20 €

Nga arsyet e lartë shënuara u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Lëndës i janë bashkangjitur: Mendimin për klasifikimin tarifor me nr.49-T/2012 datë 04.12.2012, kontrata e MPB me eksportuesin.

Nëse subjekti në procedure nuk kryen pagesën për shumën e përgjithshme të cekur në dispozitiv të këtij aktvendimi, atëherë në vështrim të nenit 223 paragrafi a. b. të Kodit Doganore dhe Akcizave të Kosovës do të ngarkohet edhe me kamatën në vonesë, përveç shumës së detyrimeve.

KËSHILLË JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Sektorit për Rishqyrtime të Vendimeve (adresa. Qyteza Pejton Rr. "Mujo Ulqinaku"-Prishtine) në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Prishtinë 13.12.2012

Kopja për: - Palën
- Dosje
- Arkiv
- Adm. e Sek .Auditimit

Udhëheqësi i Departamentit të Përmbushjes
Mr.sci Ibrahim Xhaka